



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Financave

PROJEKT PËR EFIKASITET ENERGJETIK
NË SEKTORIN PUBLIK
(IBRD 9038MK)
NUMRI IDENTIFIKUES I PROJEKTIT : P149990

**SHPALLJE PËR ANGAZHIM PUNE NË KOHË TË CAKTUAR
LIDHUR ME PROJEKTIN PËR EFIKASITET ENERGJETIK NË
SEKTORIN PUBLIK**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut mori hua nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore për realizimin e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik. Objektivat për zhvillimin e projektit janë: (i) zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorin komunal; dhe (ii) mbështetja e zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmit të qëndrueshëm për financimin e efikasitetit energjetik në sektorin publik. Projekti synon t'i realizojë këto objektiva duke mundësuar investime në ndërtesat komunale dhe qeveritare (qendrore) dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Për realizim të suksesshëm të Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, Ministria e Financave ka nevojë për angazhimin e konsulentëve individualë lokalë për pozicionet vijuese afatshkurtra:

Inxhinier i makinerisë

Kompetencat kryesore të inxhinierit të makinerisë janë: Mbështetje të njësisë për realizimin e projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik në të gjitha aspektet teknike të realizimit të projektit, duke përfshirë rishikimet teknike të raporteve për revizion energjetik dhe të sigurojë që ato të jenë në përputhje me standardet nacionale dhe ndërkombëtare për revizion energjetik dhe praktikatat më të mira; Mbikëqyrje të dokumentacionit të detajuar teknik, punime ndërtimore për rikonstruim dhe lëshimin e tyre për shfrytëzim; Zhvillim të normave teknike për të siguruar cilësi teknike të qëndrueshme; Formulim të metodologjive për matjen e kursimit të energjisë dhe funksioneve të tjera teknike.

Kualifikimet e nevojshme:

- Së paku të posedojë diplomë universitare në drejtimin e makinerisë (inxhinieria termike do të jetë përparsi); Diploma master në këtë fushë që do të jetë përparësi;
- Së paku 5 vjet përvojë profesionale në energjetikë, efikasitet energjetik, menaxhim me projekte, përvojë paraprake në përgatitjen e dokumentacionit të detajuar teknik të projekteve;
- Përvoja e punës me projektet e financuara nga institucionet ndërkombëtare do të jetë përparsi;
- Përvojë paraprake në zbatimin e projekteve për efikasitet energjetik;
- Përvoja në instalimet solare PV dhe sistemet e ngrohjes solare është përparësi.
- Shkathtësi të shkëlqyera ndërnjerezore, aftësi të demonstruara për komunikim efektiv dhe shkathtësi të jashtëzakonshme në të shkruar. Konsulenti duhet të ketë përvojë pune si pjesë e ekipit, mundësisht në pozicion lideri dhe të ketë dëshmuar aftësi për të realizuar detyra të ndërlikuara dhe për të zgjidhur sfidat që mund të paraqiten.
- Duhet të jetë i aftë në aplikacionet kryesore kompjuterike, për shembull, Word, Excel, PowerPoint, të ketë orientim të fuqishëm ndaj klientit. Shkathtësi të shkëlqyera të komunikimit me shkrim dhe verbal në gjuhën angleze dhe maqedonase.

Inxhinieri i elektrikës

Kompetencat kryesore të Inxhinierit të elektrikës janë: Mbështetje të njësisë për zbatimin e projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik në identifikimin e propozimeve për projekte



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Financave

investuese; Sigurim të përgatitjes së dokumenteve për revizion energjetik në përputhje me kriteret e përcaktuara në doracakun operativ; Vlerësim të rezultateve për revizion energjetik; Koordinim dhe sigurim të kontrollit të cilësisë në përgatitjen e projekteve të nevojshme preliminare dhe të detajuara për efikasitet energjetik; Përgatitje në bashkëpunim të ngushtë me personat zyrtarë për furnizime dhe operacione për menaxhim financiar në vlerësimin e fizibilitetit teknik, financiar dhe ekonomik të investimeve të propozuara, duke përfshirë edhe rishikimin e alternativave për uljen e kostove.

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare për elektroteknikë; Diploma e masterit në këtë fushë do të konsiderohet si përparësi
- Të paktën 5 vjet përvojë profesionale në energjetikë, efikasitet energjetik, sisteme për ndriçim dhe/ose instalime solare FV, përvojë paraprake në revizion energjetik të ndërtesave dhe përgatitje të dokumentacionit të detajuar teknik;
- Përvoja e punës me projekte të financuara nga institucionet ndërkombëtare do të jetë përparësi;
- Përvojë paraprake në zbatimin e projekteve për efikasitet energjetik;
- Përvoja në instalimet solare PV është përparësi e madhe;
- Posedim të njohurive nga rregullatvate nacionale lidhur me mjedisin jetësor, shërbimet komunale dhe furnizimet përmes agjencive qeveritare;
- Shkathësi të mira në komunikim;
- Shkathësi shumë të mira kompjuterike (Word, Excel, Access);
- Njohje të rrjedhshme të gjuhës maqedonase dhe njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze.

Personat në pozicionet e përmendura të konsulentëve, do të përzgjidhen në përputhje me Rregulloren për furnizime publike të Bankës Botërore për huamarrësit lidhur me FPI - Furnizimet në kuadër të financimit të projekteve të investimeve nga muaji korrik të vitit 2016, i rishikuar në muajin nëntor të vitit 2017 dhe gusht të vitit 2018 ("Rregullorja për furnizime").

Konsulentët e interesuar të cilët i plotësojnë këto kushte, mund të marrin më shumë informacione në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga ora **08:30** deri në **16:30**, çdo ditë pune nga e hëna deri të premten.

Konsulentët e interesuar thirren që t'i dorëzojnë biografitë e tyre në gjuhën angleze në mënyrë elektronike në word dokument ose në format pdf i cili përveç tjerash duhet përfshijë edhe verifikimin që e konfirmon kualifikimin e tyre për plotësimin e kualifikimeve të mësipërme. **(në aplikacion duhet të vendoset pozicioni për të cilin aplikohet dhe aplikacioni nuk duhet të jetë më i madh se 10 MB).**

Personat e interesuar duhet t'i dorëzojnë biografitë dhe të gjitha dokumentet e tjera përkatëse të bashkangjitura, në adresën e postës elektronike jo më vonë se data **30 qershor të vitit 2021, deri në orën 16:00** në këtë adresë:

Ministria e Financave
Dame Gruev, 12
1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
e-mail:
aleksandar.najdovski@finance.gov.mk